



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

**DPL.nr.19/2022**

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarueses private, organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.04/21, P.nr.14/21, P.nr.23/21, P.nr.43/21, P.nr.69/21, P.nr.74/21, P.nr.83/21, P.nr.138/21, P.nr.139/21, P.nr.240/21, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, Petrit Reqica, përfaqësues i palës ankuese-Divizionit për Mbikqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira dhe Përmbaruesi Privat, me datë 21.07.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-19/2022 i datës 19.05.2022, si dhe raporti-ankesa e palës ankuese Divizionit Për Mbikqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira e datës 17.05.2022, **si të pabazuara.**

**II. Përmbaruesja Private**, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në nuk është përgjegjëse për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndët përmbarimore, P.nr.04/21, P.nr.14/21, P.nr.23/21, P.nr.43/21, P.nr.69/21, P.nr.74/21, P.nr.83/21, P.nr.138/21, P.nr.139/21, P.nr.240/21.

**A r s y e t i m**

Divizioni Për Mbikqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira me datë 17.05.2022,ka parashtruar raportin e inspektimit të rregullt të kryer ndaj përmbaueses private me kosntatimin dhe pretendimin se përmbauesja private ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbaimore . Kjo nga shkaku se bazuar në raportin e inspektimit të rregullt që i është bërë përmbaueses, është konstatuar se përmbauesja private ka bërë shkelje,duke tejkaluar shumë e shpenzimeve procedurale, me inkasimin si shpenzim nga ana e debitorit shumë që i përket propozimit për përmbaimit të përpiluar nga avokati i kreditorit,ku ka llogaritur dhe inkasuar shumë prej 104 euro dhe tek rasti tjetër shumë prej 156 euro,ndërsa sipas udhëzimit për tarifën e përmbauesve privat,shuma që parashihet të inkasohet për përpilimin e propozimit , është shuma prej 20 euro. Me këtë rast përmbauesja e ka dëmtuar palën debitore,pasi ka inkasuar më tepër për këtë propozim të avokatit e me këtë ka tejkaluar tarifën në kundërshtim me udhëzimin për tarifën MD.nr.06/2014.Gjithashtu përmbauesja i ka përllogaritur si shpenzime procedurale edhe shpenzimin për vërtetim të kopjes tek noteri dhe përkthimin që i ka bërë dokumentit përmbaimitor.

### **I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmerren masa ndaj përmbaueses private.**

Me datën 19.05.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesion të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimit Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbaueses private, lidhur me veprimet përmbaimore për këtë lëndë.

Përmbauesja private, në përgjigjen e saj ka përmendur që komentet e saj të dhëna në procesverbalin e inspektimit të trajtohen si përgjigje e saj,i cili raport i inspektimit së bashku me të gjitha provat e lëndës është përcjellur me rastin e inicimit të rastit disiplinor.

Nga provat e bashkangjitura vërehet se në tarifimin për rastet e inicimit,respektivisht përpilimit të propozimeve, është inkasuar shuma prej 104 euro,respektivisht 156 euro,e cila përllogaritje ka ardhur si rezultat i llogaritjes nga ana e përmbaueses sipas rregullores për Tarifën e Odës së Avokatëve, pasi propozimet janë përpiluar nga avokati.

Gjithashtu në provat e bashkangjitura,pasqyrat e shpenzimeve është cekur se në ato shpenzime procedurale janë përfshirë edhe shpenzimet e noterizimit të dokumenteve,vërtetimit të kopjeve të dokumentit përmbaimitor si dhe përkthimin e tij .

Në seancën dëgjimore i autorizuari i palës ankuese, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës dhe të thënave të cekura në ankesë duke shtuar se në këtë rast shpenzimet për përkthim dhe noterizim të dokumenteve nuk do duhej të llogariten nga përmbauesja , ngase gjykata është ajo e cila i cakton shpenzimet, e jo përmbauesi privat.

Përmbauesja private në seancën dëgjimore poashtu ka deklaruar se sipas dispozitave të LPP-së,nevojitet që dokumenti përmbaimitor duhet të jetë i noterizuar si kopje apo origjinali e që në këtë rast noterizimi i kopjes në shumë reale sipas tarifës së noterit, pasi që kemi pasur dokument përmbaimitor dokumentin e huaj , është përkthyer dhe shuma reale e përkthimit sipas asaj që është paguar noteri dhe përkthyesi që janë të dukshme dhe reale,ato janë llogaritur.



Pretendimi se është tejkaluar tarifa lidhur me shumën e inkasuar për përpilimet e propozimeve të avokatit të palëve tek rastet e inspektuara, nuk qëndron sepse përmbaruesja nuk ka bërë kurrfarë shkelje të udhëzimit për tarifën, pasi në udhëzimin për tarifën MD.06/2014, parashihet shuma prej 20 euro për përpilimin e propozimit, nëse propozimi përpilohet nga përmbaruesi, që në këto raste, nuk ka ndodhur, pasi propozimet janë përpiluar nga përfaqësuesit e kreditorëve, avokati e që për parashitjet e përpiluara nga avokati dhe të gjitha veprimet që ndërmerren nga avokati, tarifimi bëhet sipas Tarifave të Odës së Avokatëve të Kosovës, e jo sipas udhëzimit për tarifën e përmbaruesve privat, sepse përmbaruesi nuk ka kompetencë të ndërhyjë në tarifën e Odës së avokatëve. Këtë konstatim, komisioni e bazoi në faktin se propozimet janë përpiluar nga avokati i palës kreditore gjë që shihet nga vulat dhe llogojat e avokatit dhe shpenzimet për këto propozime të përpiluara nga avokati, duhet të tarifohen sipas tarifës së Odës së Avokatëve, e jo sipas Udhëzimit për Tarifa të Përmbaruesve privat MD.06/2014.

Komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë me të cilën do të provohet se përmbaruesja private ka bërë tejkalim të tarifimit sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore tek rastet e cekuara, pasi tarifimi për të cilin është inicuar ky rast disiplinor ka të bëjë me tarifim për avokatin lidhur me shpenzimet për përpilim të propozimeve për përmbarim, të cilat janë llogaritur pikërisht sipas numrit tarifor. 6 të Rregullores Për Tarifa të Odës së Avokatëve të Kosovës të dt, 18.03.2017, e cila ka qenë në fuqi në ditën e tarifimit nga përmbaruesi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## **KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**

**DPL.nr.19/2022 datë 21.07.2022**

**Kryesuesja e Komisionit Disiplinor**  
Manushe Karaçi  
  


***KËSHILLË JURIDIKE:*** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.